



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 40, datë 21.05.2024

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 104, DATË 30.03.2023 PËRSA I PËRKET ZNJ. SHQIPE DAJA, NR. 99, DATË 30.03.2023 PËRSA I PËRKET Z. ALFRED DYLAVER BERISHA, NR. 61, DATË 28.02.2023 PËRSA I PËRKET ZNJ. SYLE DURMISHI, ZNJ. QËNDRIME DURMISHI, Z. FABRINIO DURMISHI, ZNJ. ALESIA DURMISHI, Z. AGIM DURMISHI DHE Z. MERSIN DURMISHI, NR. 109, DATË 19.10.2022 PËRSA I PËRKET ZNJ. SUZANA HAKANI, Z. BULJAN HAKANI, Z. SHUSTER HAKANI DHE Z. MIRSEL HAKANI

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 53, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i Njesisë Administrative si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfituar nga Programet e Rindërtimit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 104, datë 30.03.2023 “Për miratimin e disa shtesave në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 28.02.2023, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësine Administrative Sukth, objektet e të



cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 99, datë 30.03.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Katund i Ri, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 28.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 109, datë 19.10.2022 “Për miratimin e një shtese në aneksin 1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 05.03.2021, i ndryshuar “Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr. 458, rruga “Bajram Tusha”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhëri nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së bashkisë, i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 104, datë 30.03.2023 përsa i përket klasifikimit si përfituese të znj. Shqipe Daja në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
2. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 99, datë 30.03.2023 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Alfred Dylaver Berisha në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 28.02.2023 përsa i përket klasifikimit si përfitues të znj. Syle Durmishi, znj. Qëndrime Durmishi, z. Fabrinio Durmishi, z. Alesia Durmishi, z. Agim Durmishi dhe z. Mersin Durmishi në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 2+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
4. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 109, datë 19.10.2022 përsa i përket klasifikimit si përfitues të znj. Suzana Hakani, z. Buljan Hakani, z. Shuster Hakani dhe z. Mirel Hakani në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit,



Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për
vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.05.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 328/prot.
5

Durrës, më 29.05.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.40 datë 21.05.2024 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimet e Këshillit Bashkiak Nr 104 dt 30.03.2023 përsa I përket Znj. Shqipe Daja , Nr 99 dt 30.03.2023 përsa i përket Z.Alfred Dylaver Berisha, nr 61 dt 28.02.2023 përsa i përket Znj.Syle Durmishi, Znj.Qëndrime Durmishi, Z.Fabrinjo Durmishi, Znj.Alesia Durmishi, Z.Agim Durmishi dhe Z.Mersin Durmishi, nr 109 dt 19.10.2022 përsa I përket Znj.Suzana Hakani, Z.Buljan Hakani, Z.Shuster Hakani dhe Z.Mirsel Hakani”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMIL JAN JANI